 12. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Lejen Mjedisore (Autorizim Mjedisor), të vlefshme dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.
 13. Të paraqiten 3 (tre) mjete transporti nga të cilat dy duhet domosdoshmërisht të jenë me

kapacitet mbajtës nga 3.5 ton deri në 5 ton mjeti, dhe tjetri duhet të jetë me peshë mbajtje deri në 3 ton. Mjeti i transportit mund të jenë në pronësi ose me qera.

- a) *Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik dhe siguracioni i mjetit (i vlefshëm), certifikata e pronësisë së mjetit, siguracioni i mjetit, si dhe taksat vjetore.*
 - b) *Për mjetet e siguruara me qira duhet të paraqitet: kontrata e qirase, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurim, dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik dhe siguracioni i mjetit (i vlefshëm), certifikata e pronësisë së mjetit, siguracioni i mjetit, si dhe taksat vjetore.*
 - c) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet të deklaruara.*
 - d) *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor. Me këtë qëllim subjekti ofertues duhet të paraqesë: Deklaratë ku të deklarohet se mjetet në pronësi ose me qira do të përdoren vetëm për realizimin e kësaj kontrate dhe vendodhjen e tyre me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.*
 - e) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nga administratori ku merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit si dhe montimin dhe vendosjen nëpër vendet në adresës të autorizuara nga Autoriteti Kontraktor.*
14. Operatorët Ekonomik duhet të paraqesin mostra të cilat duhet të dorëzohen në ditën dhe orën e hapjes së ofertave pranë Autoritetit Kontraktor, konkretisht në datë 30.08.2018, ora 11:00. Lista e mostrave që duhet të paraqiten sipas specifikimeve teknike të dhëna në DT, të jenë:
- Mostër 1 (një) copë “Tavolinë Pune 180*90*72”
 - Mostër 1 (një) copë “Poltronë rrotulluese (Drejtore)”
 - Mostër 1 (një) copë “Raft i lartë ½ xham (90*46*200)”.

*Mosparaqitja e mostrave dorazi, në ditën e hapjes së ofertave, është kusht skualifikues.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimet teknike për produktet e parashikuara në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i artikujve
1	Poltrone rrotulluese (Drejtori Përgjithshëm)
2	Poltronë rrotulluese (Drejtor)
3	Karrige fikse lëkurë ekologjike
4	Karrige rrotulluese
5	Poltron fikse
6	Tavolinë pune (130*65*72) cm
7	Sirtarë të lëvizshëm me rrota (35*50*60) cm
8	Tavolinë pune (140*70*72) cm
9	Sirtarë të lëvizshëm me rrota (40*55*60) cm
10	Tavolinë pune (200*100*72) cm
11	Sirtarë të lëvizshëm me rrota (45*60*60) cm
12	Tavolinë e madhe mbledhje (8 vende)
13	Tavolinë e madhe mbledhje (200*80*72) cm
14	Tavoline pune (180*90*72) cm
15	Tavolinë kompiuteri (120*60*72) cm
16	Tavolinë printeri (50*50*60) cm
17	Raft i lartë ½ xham (90*46*200) cm
18	Raft i lartë me kapak (90*46*200) cm
19	Raft i lartë pa kapak (i hapur) (90*46*200) cm
20	Raft i lartë pa kapak (i hapur) sipër dhe me kapak poshtë (90*46*200) cm
21	Banak këndor i harkuar (150*40*110) cm
22	Tavolinë mesi (kënd pritje) (60*60*40) cm
23	Varëse rrobash (me 8 vende metalike)
24	F.V. Raft metalike për Arkive, H=3300, P=400,7 kate
25	F.V. Raft metalike për Arkive, H=2800, P=400,6 kate
26	F.V. Raft metalike për Arkive, H=3000, P=400,7 kate
27	F.V Raft metalike për Arkive, H= 2700, P=400,7 kate
28	Raft metalike per arkiven + magazinën, H= 4800, P=400, 7 kate
29	Grila vertikale te brendeshme (220*163) cm (8 cope)
30	Grila vertikale te brendeshme: (190*220,170*220,190*220,130*220,70*220) cm (5 copë)

31	Grila vertikale te brendeshme: (150*225,270*225,150*225,220*225,110*225,250*240,300*240,130*240,180*220,550*220,180*220,50*220,300*320,100*110,300*220,600*220,180*220) cm (17 copë)
32	Grila vertikale te brendeshme (200*220) cm

1. Poltronë rrotulluese (Drejtori i Përgjithshëm)

Baza në formë ylli e poltronës të ketë ka një diameter 660 mm dhe jetë e bërë me alumin. Të jetë e pajisur me rrota të dyfishta të bëra me poliamide, me një shtresë mbrojtëse e bërë po nga i njëjti material. Rregullimi i lartësisë është i mundur të arrihet përmes një leve e cila duhet të jetë nën ulëse anësore. Mekanizmi i ndejtësës duhet të jetë i pajisur me 3 versione dhe të jetë i përbërë me die-cast aluminium. Versioni i parë duhet të jetë Sinkro-mekanimem. Ai duhet të mundësojë lëvizje të njëhershme dinamike të ulëses me 11° dhe mbeshtësës me 18° dhe të mundësojë 5 pozicione të mbylljes. Mekanizmi të jetë i pajisur me funksion «anti-panik» dhe duhet të përshtatet sipas peshës së përdoruesit. Aktivizimi dhe deaktivizimi i lëvizjeve Sinkro duhet arrirë nëpërmjet të njëjtës levë që përdoret për rregullimin e lartësisë e ulëses. Rregullimi i peshës duhet kryer nëpërmjet një vide e cila është pozicionuar në zonën e përparme dhe nën ndejtësen. Ndejtesja duhet të jetë e përbërë me fletë druri të presuara dhe ka një trashësi finale prej 12 mm. Nën ndejtësen duhet të ketë një jastëk i bërë me shkumë poliuretani me trashësi 40 mm, e cila është e veshur me susta me pëlhurën e zgjedhur. Dimensioni i ndejtësës: gjerësia 480 mm, thellësia 470 mm. Mbështetësja të jetë e lartë dhe të sigurojë përputhje hergonomike të trupit. Mbështetëset e duarve të poltronës të jenë me gjatësi të rregullueshme deri në 80 mm (distanca 190-270 nga sipërfaqja e ndejtësës) dhe me gjerësi të rregullueshme nga 450-510 mm. Përmasat e sipërme të mbështetjes së duarve të kenë dimensionet 230x82mm. Mbështetëset e duarve, jastekët e krahëve dhe kllapat montuese të jenë të bëra nga injektimi i poliamide. Tapiceria të jetë me lëkurë origjinale.

2. Poltronë rrotulluese (Drejtor)

Baza në formë ylli e poltronës të ketë një diametër 660 mm dhe jetë e bërë me alumin. Të jetë e pajisur me rrota të dyfishta të bëra me poliamide, me një shtresë mbrojtëse e bërë po nga i njëjti material. Rregullimi i lartësisë është i mundur të arrihet përmes një leve e cila duhet të jetë nën ulëse anësore. Mekanizmi i ndejtësës duhet të jetë i pajisur me 3 versione dhe të jetë i përbërë me die-cast aluminium. Versioni i parë duhet të jetë Sinkro-mekanimem. Ai mundëson lëvizje të njëhershme dinamike të ulëses me 11° dhe mbeshtësja me 18° dhe mundëson 5 pozicione të mbylljes. Mekanizmi të jetë i pajisur me funksion «anti-panik» dhe duhet të përshtatet sipas peshës së përdoruesit. Aktivizimi dhe deaktivizimi i lëvizjeve Sinkro duhet arrirë nëpërmjet të njëjtës levë që përdoret për rregullimin e lartësisë e ulëses. Rregullimi i peshës duhet kryer nëpërmjet një vide e cila është e pozicionuar në zonën e përparme dhe nën ndejtësen. Ndejtesja duhet të përbëhet nga fletë druri të presuara dhe të ketë një trashësi finale prej 12 mm. Nën ndejtësen duhet të ketë një jastëk i bërë me shkumëpoliuretani me trashësi 40 mm, e cila është e

veshur me susta me pëlhurën e zgjedhur. Dimensioni i ndejtëses: gjerësia 480 mm, thellësia 470 mm. Mbështetësja të jetë e lartë dhe të sigurojë përputhje hergomike te trupit. Mbështetëset e duarve të poltronës të jenë me gjatësi të rregullueshme deri në 80 mm (distanca 190-270 nga sipërfaqja e ndejtëses) dhe me gjerësi të rregullueshme nga 450-510 mm. Permasat e sipërme të mbështetjes së duarve të kenë dimensionet 230x82 mm. Mbështetëset e duarve, jastëket e krahëve dhe kllapat montuese të jenë të bëra nga injektimi i poliamide. Tapiceria të jetë me lëkurë origjinale.

3. Karrige fikse lëkure ekologjike

Korniza e karriges është e përbërë nga tub çeliku me një seksion kryq të rumbullakët me diametër 16 mm dhe 1,5 mm trashësi, të përshtatshme për ti vendosur dhe njëra mbi tjetren. Ndenjësja dhe mbështetëse e karriges të jenë të përbëra me memory foam e veshur me copë me ngjyrë sipas dëshirës. Përmes elementeve të veçanta plastike është e mundur për të lidhur karriget pranë njëra-tjetrës në formë rreshtash. Karrige pa krah statike. Gjerësia: 495 mm, thellësia, 540 mm dhe lartësia: 650 mm.

4. Karrige rrotulluese

Baza e karrikes në formë ylli të ketë një diametër prej 660 mm dhe të jetë e përbërë me alumin i veshur me poliamid. Të ketë rrota të dyfishta të bëra me poliamide, me një shtresë mbrojtëse e përbërë po nga i njëjti material. Rregullimi i lartësisë të jetë i mundur të arrihet përmes një leve e cila gjendet nën ulësen anësore. Mekanizmi i ndejtëses i bërë me die-cast aluminium me mekanizmi Relax. Të mundësohen lëvizjet automatike të mbështetëses kështu që trupi e shoqëron, me forcë kthimi të rregullueshme në varësi të peshës. Ndejtesja të jetë e përbërë nga flete druri të presuara dhe të ketë një trashësi finale prej 12 mm. Në ndejtesen të ketë një jastëk i përbërë me shkumë poliuretani me trashësi 40 mm e veshur me pëlhurën e zgjedhur. Mbështetëset e duarve të karrikes të kenë gjatësi të rregullueshme. Permasat e sipërme të mbështetjes së duarve duhet të jenë 230x62 mm.

5. Poltron fikse

Karakteristika kryesore: design ergonomik dhe anatomik, me krahë, me ndenjëswe të veçuar nga shpina, e cila mbështet çdo lëvizje të trupit, duke nxitur një sjellje të shëndetëshme dhe dinamike.

Korniza të jetë e krijuar me tub çeliku me diametër 26 mm në një formë “C”, që lejon një lëvizje relaks.

Skeleti i karriges D26x2. Ndenjëse druri me trashësi 10mm. Ndenjëse shkume me trashësi 40 mm.

Shpinë druri me trashësi 10 mm e veshur me tapiceri ecopelle dhe sfungjer. Shpinë shkume me trashësi 40 mm e veshur me tapiceri ecopelle dhe sfungjer.

6. Tavoline pune

Dimensionet: (130*65*72) cm dhe (140*70*72) cm

Tavolina duhet të ketë material komposit druri me veshje melaminë kategoria E1. Suprina të jetë i të njëjtit material me trashësi 25 mm ngjyrë rover. Këmbët të jenë me plane të të njëjtit material dhe trashësi të suprinës dhe me ballore të mbyllur. Tavolina të jetë lineare me permasaq 130 cm dhe anësore 65 cm. Pjesa ballore të jetë e pozicionuar në mënyrë të tillë që të realizojë bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe të qëndrojë në një hapësirë jo më të madhe se 40 cm nga dyshemeja. Këmbët e tavolinës të jenë me mekanizëm nivelues. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Të eliminohet kontakti i këmbëve të tavolinës me dyshemenë.

Në krah të majtë të tavolinës të krijohet hapësira për vendosjen e njësisë dhe vendosjen e UPS-it, e ndarë në pjesë në lartësi, respektivisht: gjatësi 25 cm* lartësi 43 cm* dhe 21 cm dhe thellësi sa gjerësia e tavolinës.

Në suprinën e tavolinës të vendoset pajisja "dritare" në qendër për kalimin e përqëndruar të kablllove.

Suprina ëe ketë dalje nga konturet e këmbëve mbështetëse sipas standardit.

Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Veshja të jetë me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve, njollave dhe lagështisë. Produkti duhet të plotësojnë kushtet e fizike dhe mekanike në qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi.

Ngjyra të jetë Rover.

Cilësi e parë, prodhim importi ose vendi që plotëson kërkesat e standardeve europiane.

7. Sirtareve te levizshem me rrota

Dimensionet: (35*50*60) cm dhe (40*55*60) cm

Struktura e komodinës do jetë prej materiali komposit druri dhe veshje me Melaminë, kategoria E1, me trashësi të të gjitha paneleve vertikal dhe horizontal 15-20 mm. Sirtariera duhet të ketë 4 rrota në fund dhe të mund të lëvizë nën tavolinë. Sirtaret të ndahen në mënyrë të barabartë. Sirtarët duhet të jenë të pajisur me kyç që të realizojë mbyllje qendrore. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit.

Aksesorët e përdorur duhet të jenë cilësorë, në mënyrë që të sigurojnë një qëndrueshmëri të lartë të sirtarierës. Veshja duhet të sigurojë rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave dhe lagështisë. Produkti duhet të plotësojë kushtet fizike dhe mekanike në qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi. Ngjyra të jetë e njëjtë me tavolinën e punës.

8 Tavoline pune

Dimensionet: 200*100*72 cm

Tavolina duhet të jetë e përbërë nga material komposit druri me veshje melamine, kategoria E1. Suprina të jetë i të njëjtit material me trashësi 25 mm ngjyrë rover. Këmbët të jenë me plane të të njëjtit material dhe trashësi të suprinës dhe me ballore të mbyllur. Tavolina të jetë lineare me përmasa 200 cm dhe anësore 100 cm. Pjesa ballore të jetë e pozicionuar në mënyrë të tillë që të realizojë bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe të qëndrojë në një hapësirë jo më të madhe se 40 cm nga dyshemeja. Këmbët e tavolinës të jenë me mekanizëm nivelues. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit.

Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Veshja të jetë me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve, njollave dhe lagështisë. Produkti duhet të plotësojë kushtet e fizike dhe mekanike në qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi. Ngjyra rover.

9 Sirtarë të lëvizshëm me rrota

Dimensionet: 45*60*60 cm

Struktura e komodinës duhet të jetë e përbërë prej materiali komposit druri dhe veshje me Melaminë kategoria E1, me trashësi të të gjitha paneleve vertikal dhe horizontal 15-20 mm. Sirtariera duhet të ketë 4 rrota në fund dhe të mund të lëvizë nën tavolinë. Sirtaret të ndahen në mënyrë të barabartë. Sirtarët duhet të jenë të pajisur me kyç që të realizojnë mbyllje qendrore. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit.

Aksesorët e përdorur duhet të jenë cilësorë, në mënyrë që të sigurojnë një qëndrueshmëri të lartë të sirtarierës. Veshja duhet të sigurojë rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave dhe lagështisë. Produkti duhet të plotësojë kushtet fizike dhe mekanike në qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi. Ngjyra të jetë e njëjtë me tavolinën e punës.

10 Tavoline e madhe mbledhje (8 vende)

Dimensionet: 200*100*72 cm

Plani i punës të jetë i realizuar prej paneli me pjesë druri ekologjik, Klasi E1, i veshur me rimeso druri dekorative në ngjyrë palisandro me trashësi 38 mm. Këmbët të jenë prej metali me diameter 60 mm, me ngjyrë të zezë mat, me suport dekorativ metalik. Të gjitha pjesët e tavolinës të lidhen me aksesorë metalik për të bërë lehtësisht të mundshëm montimin dhe çmontimin. Aksesorët e përdorur duhet të jenë cilësorë. Veshja duhet të sigurojë rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave dhe lagështisë. Produkti duhet të plotësojë kushtet e fizike dhe mekanike në qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi. Produkti duhet të plotësojë kushtet fizike dhe mekanike në qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi. Ngjyra të jetë rover.

11 Tavolinë e madhe mbledhje

Dimensionet: 200*100*72 cm

Plani i punes i realizuar prej paneli me pjese druri ekologjik classe E1,veshur me rimeso druri dekorative ne ngjyre palisandro me trashesi 38 mm. Kembet të jenë prej metali diameter 60 mm, në ngjyrë të zezë mat, me suporte dekorative metalike. Të gjitha pjesët e tavolinës lidhen me aksesore metatike për të bërë lehtësisht të mundshëm montimin dhe çmontimin. Aksesorët e përdorur duhet të jenë cilësorë, në mënyrë që të sigurojnë një qëndrueshmëri të lartë. Veshja duhet të sigurojë rezistencë te lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave dhe lagështisë. Produkti duhet të plotësojë kushtet fizike dhe mekanike në qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi. Ngjyra të jetë rover.

12 Tavolinë pune

Dimensionet: (180*90*72) cm

Tavolina duhet të jetë të përbërë me material komposit druri me veshje melaminë kategoria E1. Suprina të jetë i të njëjtit material me trashësi 25 mm me ngjyrë rover. Këmbët janë me plane të të njëjtit material dhe trashësi të suprinës dhe me ballore të mbyllur. Tavolina të jetë lineare me përmasa 180 cm dhe anësore 90 cm. Pjesa ballore është e pozicionuar në mënyrë të tillë që realizojë bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë jo më të madhe se 40 cm nga dyshemeja. Këmbët e tavolinës të jenë me mekanizëm nivelues. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit.

Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Veshja të jetë me rezistencë te lartë kundër gërvishtjeve, njollave dhe lagështisë. Produkti duhet të plotësojë kushtet fizike dhe mekanike në qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi. Ngjyra të jetë rover.

13 Tavolinë kompiuteri

Dimensionet: (120*50*72) cm

Tavolina duhet të jetë prej materiali komposit druri me veshje melaminë kategoria E1. Suprina të jetë i të njëjtit material me trashësi 25 mm me ngjyrë rover. Këmbët janë me plane të të njëjtit material dhe trashësi të suprinës si dhe me ballore të mbyllur. Tavolina të jetë lineare me përmasa 120 cm dhe anësore 60 cm. Pjesa ballore të jetë e pozicionuar në mënyrë të tillë që realizojë bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë jo më të madhe se 40 cm nga dyshemeja. Këmbët e tavolinës të jenë me mekanizëm nivelues. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit.

Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Veshja të jetë me rezistencë te lartë kundër gërvishtjeve, njollave dhe lagështisë. Produkti duhet të plotësojë kushtet fizike dhe mekanike në qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi. Ngjyra të jetë rover.

14 Tavoline printeri

Dimensionet: (50*50*60) cm

Tavolina duhet të jetë material e përbërë prej materiali komposit druri me veshje melaminë kategoria E1. Suprina të jetë i të njëjtit material me trashësi 25 mm me ngjyrë rover. Këmbët janë me plane të të njëjtit material dhe trashësi të suprinës si dhe me ballore të mbyllur. Tavolina të jetë lineare me permasa 50 cm dhe anësore 50 cm. Pjesa ballore të jetë e pozicionuar në mënyrë të tillë që të realizojë bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë jo më të madhe se 40 cm nga dyshemeja. Këmbët e tavolinës të jenë me mekanizëm nivelues. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit.

Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Veshja të jetë me rezistencë të lartë kundër gërvishetjeve, njollave dhe lagështisë. Produkti duhet të plotësojë kushtet fizike dhe mekanike në qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi. Ngjyra të jetë rover.

15 Raft i lartë ½ xham

Dimensionet: (90*46*200) cm

Struktura e raftit do të jetë prej materiali komposit druri dhe veshje me Melaminë kategoria E1, me trashësi të mureve prej 18mm dhe e rafteve prej 25mm. Rafti të ketë dy kanatea me porta e mbyllur dhe çelës dhe dy kanate 80-cm me xham dhe kornize alumini për të qenë sa më kompakte. Kornizat e raftit të jenë të përbëra prej materiali komposit druri dhe veshje me Melaminë kategoria E1 dhe të kenë rregullator nivelimi nga 0 – 10 mm me rregullim shtesë të brendshëm. Ngjyra të jetë sipas ngjyrës së tavolinës së punës. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit.

Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të raftit të jenë cilësorë. Veshja të jetë me rezistencë të lartë kundër gërvishetjeve, njollave dhe lagështisë. Produkti duhet të plotësojë kushtet fizike dhe mekanike në qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi.

16 Raft i lartë me kapak

Dimensionet: (90*46*200) cm

Struktura e raftit do të jetë prej materiali komposit druri dhe veshje me Melaminë kategoria E1, me trashësi të mureve prej 18mm dhe e rafteve prej 25mm. Rafti të ketë katër kanate, dy prej të cilëve me permasa 80-cm dhe dy të tjerët me permasa 120-cm me portë të mbyllur dhe çelës. Kornizat e raftit të jenë të përbëra prej materiali komposit druri dhe veshje me Melaminë kategoria E1 dhe të kenë rregullator nivelimi nga 0 – 10 mm, me rregullim shtesë të brendshëm. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit.

Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të raftit të jenë cilësorë. Veshja të jetë me rezistencë të lartë kundër gërvishetjeve, njollave dhe lagështisë. Produkti duhet të plotësojë kushtet fizike dhe mekanike në qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi.

17 Raft i lartë pa kapak i hapur

Dimensionet: (90*46*200) cm

Struktura e raftit do jetë prej e përbërë prej materiali komposit druri dhe veshje me Melaminë kategoria E1, me trashësi të mureve dhe rafteve prej 25mm. Kornizat e raftit të jenë të përbëra prej materiali komposit druri dhe veshje me Melaminë kategoria E1, të kenë rregullator nivelimi nga 0 – 10 mm, me rregullim shtesë të brendshëm. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit.

Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të raftit të jenë cilësorë. Veshja të jetë me rezistencë të lartë kundër gërvishjeve, njollave dhe lagështisë. Produkti duhet të plotësonë kushtet fizike dhe mekanike në qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi.

18 Raft i lartë pa kapak i hapur sipër dhe me kapak poshtë

Dimensionet: (90*46*200) cm

Struktura e raftit do jetë e përbërë prej materiali komposit druri dhe veshje me Melaminë kategoria E1, me trashësi të mureve prej 18 mm dhe të rafteve prej 25mm. Rafti të ketë dy kanata në pjesën e poshtme të mbyllura me çelës. Kornizat e raftit të jenë prej materiali komposit druri dhe veshje me Melaminë kategoria E1, të kenë rregullator nivelimi nga 0 – 10 mm si dhe rregullim shtesë të brendshëm. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit.

Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të raftit të jenë cilësorë. Veshja të jetë me rezistencë të lartë kundër gërvishjeve, njollave dhe lagështisë. Produkti duhet të plotësonë kushtet fizike dhe mekanike në qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi.

19 Banak kendor i harkuar

Dimensionet: Dimensione orientuese (paraprake): Banak këndor i harkuar (150*40*110) cm

Recepsioni të përbëhet nga sporteli ku të gjitha sipërfaqet janë bërë nga 18 mm mdf e bardhë, e veshur me llak të bardhë përmasat e të cilit duhet të jenë 150 x 40 x 110 cm. Sporteli është i përbërë nga dy palë që janë të lidhura me një panel ndërmjet tyre, në mënyrë që të krijojë një «II» për bazën formë, mbi të cilin sipërfaqja e punës është vendosur. Mbi sipërfaqen e punës të ketë një counter dhe të ketë paneli i tij përpara në një «Γ», forma të cilat janë të mbështetura nga raftet e krijuara në banak për mbajtjen e mjeteve dhe gjithë kancelerive të ndryshme. Sipërfaqja e punës të ketë dy vrima nikel-kromuar metalike për kabllot. Gjithashtu nga të dyja anët të jetë i pajisur me dy dollape me një portë të mbyllur, ku njëri krah të jetë për mbajtjen e pc ku dhe është i pajisur me një grilë për ventilimin dhe ajrosjen. Dollapet të jenë të pajisur me sergjenë

prej 25 mm ku mund të rregullohet nivelimi i tyre nga 0-20 mm, ndërsa dera me një trashësi prej 18mm. Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Veshja të jetë me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve, njollave dhe lagështisë. Produkti duhet të plotësojë kushtet e fizike dhe mekanike në qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi.

20 Tavolinë mesi (kënd pritje)

Dimensionetr: (60*60*40) cm

Tavolina e mesit të jetë me material komposit druri mdf, ngjyrë arre, me trashësi spresori 40 mm, ngjyra do percaktohet në momentin e lidhjes së kontratës, këmbët të kenë aksesorë për nivelimin e saj dhe mbrojtjen e gërvishtjeve nga dyshemeja. Të pakëtohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Veshja të jetë me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve, njollave dhe lagështisë. Produkti duhet të plotësonë kushtet fizike dhe mekanike në qëndrueshmëri dhe jetëgjatësi.

21 Varëse rrobash me 8 vende metalike

Koka prifti komplet me strukture metalike e rëndë dhe solide me ngjyrë të zezë. Ka 8 vende për të varur rrobat, të jetë fleksibel për t'i lëvizur lartë e poshtë, të jenë të rrotullueshme në pozicione sipas nevojave, ndërsa të ketë edhe katër vende për mbajtëse të çadrave të përmasave të ndryshme, në pjesën fundore të jetë i pajisur me një aksesor plastik 42 diametër ku shërben si pjesë për të mbajtur ujën ku kullojnë çadrat. Përmasat të jenë 170 cm dhe diametër 42 D. Montimi dhe çmontimi të jetë i thjeshtë .

21 Raft metalik arkive

Raftet të jenë të përbëra prej çeliku special S400 të zinkuar me procesin SENDZIMIR (proces zinkimi në elektrolizë);

Të jenë të regjistrueshme çdo 3 cm;

Të jenë të pakorrodueshme;

Të jenë lehtësisht të çmontueshëm dhe estetikë;

Koeficienti i sigurisë të jetë 2 që do të thotë të kenë dyfishin e kapacitetit të këshilluar për llojin e raftit;

Raftet të kenë çertifikatë cilësie ISO 9001:2015;

Të jenë prodhim sipas standarteve të CE.

22. Grila vertikale te brendëshme

Dimensionet:

(220*163,190*220,170*220,190*220,130*220,70*220,150*225,270*225,150*225,220*225,110*225,250*240,300*240,130*240,180*220,550*220,180*220,50*220,300*320,100*110,300*220,600*220,180*220, 200*220) cm

Grilat do të jenë të përbëra nga shirita vertikale me gjerësi 12 – 13 cm. Do të përfshijnë mekanizmin për hapje – mbyllje, rrotullim, të përshtatshëm për montimit në tavan. Ngjyra do të jetë e lehtë mes “PANA dhe BEZHE” në përshtatje dhe harmoni me ngjyrën e zyrave.

Shënim:

Para realizimit të prodhimit për çdo ndryshim të mundshëm gjatë kësaj kohe, duhet të realizohet një kolaudim verbal me porositesin dhe që nuk influencon në kosto.

Lidhur me ngjyrën e grilave (perdeve) vertikale do mbetet preference e porositesit dhe do të vendoset midis palëve në momentin e blerjes së produktit të gatshëm. Koncepti perde nënkupton poliestrën, mekanizmin zhvendosës dhe aksesore të tjerë të funksionimit të mekanizmit.

Lidhur me banakun e recepsionit përmasat e dhena janë për konceptimin e tij. Dimensionet dhe elementët e tjera që lidhen me prodhimin e banakut do të vendosen para prodhimit të produktit midis palëve.

Raftet metalike të arkives të realizohen si ato ekzistuese që ndodhen në zyrën e Arkivës në FSDKSH.

Subjekti ofertues duhet të deklarojë garancinë e mallrave objekt prokurimi e cila duhet të jetë jo më pak se një vit. Gjatë gjithë periudhës së garancisë ofertuesi duhet të sigurojë riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin pa pagesë konform specifikimeve teknike.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Shtojca11

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

PLANIFIKIMI I KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

--

Dokumentat Standarde të Tenderit

Mall:		Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes
Kuatër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		



Shtojca 12

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuatër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr.	Emërtimi i artikujve	Njësia	Sasia
1	Poltronë rrotulluese (Drejtori Përgjithshëm)	Copë	1
2	Poltronë rrotulluese (Drejtor)	Copë	25
3	Karrige fikse lëkure ekologjike	Copë	68
4	Karrige rrotulluese	Copë	140
5	Poltron fikse	Copë	10
6	Tavolinë pune (130*65*72) cm	Copë	32
7	Sirtarë të lëvizshëm me rrota (35*50*60) cm	Copë	32
8	Tavolinë pune (140*70*72) cm	Copë	21
9	Sirtarë të lëvizshëm me rrota (40*55*60) cm	Copë	22
10	Tavolinë pune (200*100*72) cm	Copë	1
11	Sirtarë të lëvizshëm me rrota (45*60*60) cm	Copë	4
12	Tavolinë e madhe mbledhje (8 vende)	Copë	1
13	Tavolinë e madhe mbledhje (200*80*72) cm.	Copë	1
14	Tavolinë pune (180*90*72) cm	Copë	2
15	Tavolinë kompiuteri (120*60*72) cm	Copë	1
16	Tavolinë printeri (50*50*60) cm	Copë	6
17	Raft i lartë ½ xham (90*46*200) cm	Copë	24
18	Raft i lartë me kapak (90*46*200) cm	Copë	17
19	Raft i lartë pa kapak (i hapur) (90*46*200) cm	Copë	5
20	Raft i lartë pa kapak (i hapur) sipër dhe me kapak poshtë (90*46*200) cm	Copë	5
21	Banak këndor i harkuar (150*40*110) cm	Copë	1
22	Tavolinë mesi (kend pritje) (60*60*40) cm	Copë	1
23	Varëse rrobash (me 8 vende metalike)	Copë	32
24	F.V Raftë metalike për Arkive, H=3300, P=400,7 kate	ml	19.7
25	F.V Raftë metalike për Arkivë, H=2800, P=400,6 kate	ml	4
26	F.V Raftë metalike për Arkive, H=3000, P=400,7 kate	ml	12
27	F.V Raftë metalike për Arkivë, H= 2700, P=400,7 kate	ml	36
28	Raftë metalike për arkiven + magazinën, H= 4800, P=400, 7 kate	ml	4.8

Dokumentat Standarde të Tenderit


29	Grila vertikale të brendëshme (220*163) cm (8 copë)	m ²	28.7
30	Grila vertikale të brendëshme: (190*220,170*220,190*220,130*220,70*220) cm (5 copë)	m ²	16.5
31	Grila vertikale të brendëshme: (150*225,270*225,150*225,220*225,110*225,250*240,300*240,130*240,180*220,550*220,180*220,50*220,300*320,100*110,300*220,600*220,180*220) cm (17 copë)	m ²	93
32	Grila vertikale të brendëshme (200*220) cm	m ²	4.4

Produktet e parashikuara do të shpërndahen në Tiranë, Vlorë, Pogradec dhe Lushnje sipas nevojave përkatëse të secilës Drejtori apo Degë.

Kjo shpërndarje do të kryhet mbështetur në kërkesat e herëpashershme të Autoritetit Kontraktor, në vendet dhe në adresat e autorizuara nga ky i fundit.

Afatet e lëvrimit: 60 ditë nga momenti i lidhjes së kontratës me Autoritetin Kontraktor.

Afati i lëvrimit të mallit duhet që të kryhet në çdo rast brenda datës 31/12/2018.



Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< Emri >

Shtojca 14

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

* * *

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.*

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe*

Dokumentat Standarde të Tenderit

referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]



Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të suksesshëm]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikiisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Dokumentat Standarde të Tenderit

Emri i plotë i shoqërisë _____

numri i NIPT-it _____

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____

numri i NIPT-it _____

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____

numri i NIPT-it _____

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16

KUSHTET E PËRGJITHSHME **Mallrat – Tender i Hapur**

Neni 1: Qellimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruarra me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitësi tek blerësi.
- 2.4 “Lëvrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifaf, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi,

kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gaztë.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikant e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të

emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Pronësia Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtojë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronësisë intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar.

Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

